



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA DEVOLL
NJËSIA E PROKURIMIT**

Nr _____ Prot

Devoll më ____/____/ 2025

PROCES-VERBAL – Tipi i kontratës – Sherbim
**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E TERMAVE TE REFERENCES,
SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky proces-verbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

I mbajtur sot më datë _____.____.2025, në **Bashkinë Devoll**, nga Njësia e Prokurimit, ne lidhje me argumentimin dhe miratimin e dokumenteve të tenderit, specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta për kualifikim, për procedurën e prokurimit me të dhënat e mëposhtme:

OBJEKTI I PROCEDURËS: Plane mbarështimi për pyjet

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
90712200-3 Planifikimi strategjik i ruajtjes së pyjeve

Fondi limit: 25,913,170 (njetet e pesë milion e nëntëqind e trembëdhjetë mijë e njëqind e shtatëdhjetë) lekë pa tvsh ose 264,879 (dyqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e teteqind e shtatëdhjetë e nente) Euro

Kursi i këmbimit sipas Bankes së Shqipërisë dt. 03.09.2025 është 97.83 (nëntëdhjetë e shtatë pike tetedhjetë e tre)Lek/Euro .

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Devoll** ka hartuar proces-verbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP i ndryshuar, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” Nenin 82 “Formulari permbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të Nenit 26 “Formulari permbledhës i vetdeklarimit” dhe nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik i ndryshuar

Neni 82, i LPP “1. Bashke me dorezimin e kerkesave per pjesemarrje ose te ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojne si prove paraprake ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin permbledhës te vetdeklarimit, sipas parashikimeve te ketij ligji. Permbajtja e ketij formulari percaktohet ne rregullat e prokurimit publik”.

Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme): me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022-2023-2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se dyfishi i vlerës së perlllogaritur të kontratës.

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e perlllogaritur të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.i ndryshuar

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në **nenin 77 pika 3 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar**, ku parashikohet se: “*Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar*

kontratën”, “Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës”.

si dhe bazuar nënenin **43, pika 2/a, nenin 47 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”**, parashikohet se:

Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

*a) dyfishin e vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e **prokurimit mbi kufirin e lartë monetar**;*

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

Duke marrë në konsideratë vlerën e fondit limit të kësaj procedure prokurimi, kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet **të jetë jo më e vogël se dyfishi i vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet** dhe vendosja e këtij limiti nuk kufizon pjesëmarrjen e operatoreve ekonomike.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Autoriteti Kontraktor në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda **datës 31 mars të vitit pasardhës**, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.” pasi tatimpaguesit (operatorët ekonomikë) kanë detyrimin të dorëzojnë në administratën tatimore brenda **datës 31 mars të vitit pasardhës** bilancin kontabël së bashku me anekset e tij, si dhe Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar në rastet kur plotësohen kushtet e parashikuara nga ligji.

2.2.2 Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tri) viteve të fundit financiare (2022, 2023, 2024) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar. (Kjo kërkesë do të

konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit).

Shënim: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma "c" të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, ku parashikohet se: "Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga Enti Publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera dhe afati i përfundimit të kontratës dhe faturen tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar dhe nenin 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar . Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë

të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë **në një vlerë jo më të vogël se 40 %** të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është vendosur që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme si dhe përvojën e duhur, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së shërbimeve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Vetë legjislacioni na përcakton qarte periudhën e kërkuar, vlerën e kërkuar dhe dokumentacionin konkret që duhet të dorëzojnë ofertuesit për të vërtetuar që kanë realizuar shërbime të ngjashme.

2.3.2 Për të vërtetuar që ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë dhe sipas termave objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të vërtetojë se ka të punësuar të paktën 8 (Tete) punonjës, nga të cilët 1 (një) Inxhinier Pyjesh të jetë dhe figurojë si Drejtues Teknik.

Ky staf kryesor duhet të jetë i kualifikuar dhe trajnuar mirë në Hartimin e Planit të Mbareshtimit, me eksperiencë në fushat respektive të mbareshtimit të pyjeve dhe kullotave, të cilët duhet të disponojnë të paktën certifikimet/Licensimet si më poshtë vijon:

- a) *Te pakten 1 (një) Inxhinier Pyjesh i cili do të jetë dhe Drejtues Teknik, certifikuar si ekspert pyjesh dhe kullotash,*
- b) *Te pakten 2 (Dy) Inxhiniera Pyjesh, të certifikuar si eksperte pyjesh dhe kullotash.*
- c) *Te pakten 2 (Dy) teknike Pyjesh, me eksperiencë, verifikuar me dokumentacionin perkates.*
- d) *Te pakten 1 (një) Inxhinier Gjeodet / Gjeoinformatike, Certifikuar për njohuri të avancuara të sistemeve GIS per te analizuar dhe vizualizuar të dhënat hapsinore gjithashtu për ekspertizë në konfigurimin dhe administrimin e sistemeve GIS.*

Për të vërtetuar disponimin e stafit të mësipërm operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- **Diplomat/ Per tekniket dëftesë pjekurie që ka mbaruar shkollën e mesme pyjore**
- **Certifikata përkatëse të specializimit vetëm për inxhinieret (që duhet të jenë të vlefshme në momentin e hapjes së ofertave).**
- **Kontratën/at individuale të punës konform legjislacionit në fuqi të lidhura të pakten me stafin e mësipërm.**

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve **minimum për muajin e fundit të deklaruar** nga data e hapjes së ofertave dhe listëpagesat përkatëse të konfirmuara nga autoritetet përgjegjëse, shoqëruar me formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

(Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT.

Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti ko

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar i cili parashikon se: “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”. dhe nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar Gjithashtu kriteri i mesipërme është përcaktuar bazuar në germen “b”, pika 2 e nenit 11 të ligjit nr. 57/2020 “Për Pyjet”.

Qellimi dhe objektivi final i ketyre kriterëve është Hartimi i PMPK bazuar në parimin e mbareshtimit të qëndrueshëm që nënkupton "te ruaje dhe te forcoje gjendjen shëndetësore të ekosistemeve pyjore për një afat kohe të gjatë dhe në të njëjtën kohë për të siguruar mundësi ekologjike, sociale, ekonomike dhe kulturore për mirëqenien e brezave aktuale dhe atyre të ardhshëm".

Hartimi i planit të mbareshtimit është një mjet për të njohur gjendjen aktuale të territorit, siguron një ndëveprim me aktorët si dhe kordinim nepermjet përdorimit të SISP dhe kjo pritet të ndodhë gjatë hartimit të PMPK dhe gjatë drejtimit të nderhyrjeve dhe ngjarjeve në periudhën e vlefshmerisë së kontratës dhe planit. Përdorimi i një metode të standartizuar të punës së përcaktuar në Udhëzuesin e Planeve të Mbateshtimit të Pyjeve dhe Kullotave 2019, duhet të shërbejë për të siguruar rezultate homogjene dhe të krahasueshme në nivel lokal duke përdorur procedurat që ofrohen nga SISP.

Sipas Udhëzuesit, procesi i hartimit të PMPK duhet të zhvillohet sipas ketyre hapave:

- Puna përgatitore

- Puna në terren

- Puna në zyrë

Sigurimi i proceseve si mesipër, dhe mos rrezikimi i zbatimit të kontratës, bën të nevojshëm stafin e përcaktuar në këto kriter.

Kërkesa e mesipërme është përcaktuar bazuar në “Manualin e planeve të mbateshtimit të pyjeve dhe kullotave”, miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit me shkresën nr. 864 prot., dt. 30.01.2019.

Bazuar në kërkesat e pikës 2 të gërmes A.1 “KONTROLI I DISPONIBILITETIT DHE AFTESIVE PROFESIONALE TË STAFIT TË SHËRBIMIT PYJOR BASHKIAK”, germa C.2 “Ndarja e Ekonomisë Pyjore në parcela dhe nënparcela”, C.3.2 “HYRJA E PLANIT TË RI TË MBATESHTIMIT NË SISP

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në ”Manualin e planeve të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave”, të miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me Nr.864 prot., datë 30.01.2019 ”Kontrolli i disponibilitetit dhe aftësive profesionale të stafit teknik”. Bazuar në kërkesat e germës A1 “Kontrolli i disponibilitetit dhe aftësive profesionale të stafit teknik” dhe germës D.1.1” Perberja e ekipit të punës”, të ” Manuali i planeve të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave”, të miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me Nr.864 prot., datë 30.01.2019“, të pikës 4 të nenit 77 të Lgjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në pikën 4 gërma b, c e nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Me ane te ketij kriteri kerkohet qe opertoret ekonomike te deshmojne qe kane **“fuqine punetore te nevojshme per ekzekutimin e objektit te prokurimit”**, qe kane ne dispozicion apo qe mund ti vihet.

Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale etj., reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Kërkesa për staf është e nevojshme për të garantuar Autoritetin Kontraktor se OE disponon kapacitetet me qëllim përmbushjen e objektivave të kontratës, qëllimit dhe rezultateve që pritet të arrihen.

Numri i përcaktuar për secilin specialist është përlllogaritur, duke marrë në konsideratë proceset, veprimtaritë apo shërbimet që përfshihen për realizimin e kontratës dhe është në përpjesëtim me natyrën, përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe limitet kohore të parashikuara për të përfunduar këtë kontratë.

Gjithashtu bazuar në ”Manualin e planeve të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave”, të miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me Nr.864 prot., datë 30.01.2019 ”Kontrolli i disponibilitetit dhe aftësive profesionale të stafit teknik”. Bazuar në kërkesat e germës A1 “Kontrolli i disponibilitetit dhe aftësive profesionale të stafit teknik”, aktiviteti i pare eshte zgjedhja e eksperteve qe do merren me hartimin e PMPK. Keta eksperte do te jene nga stafi i sherbimit pyjor te cilet ne pergjithesi jane inxhinjere pyjesh dhe qe duhet te jene pjese e ekipit te punes, sepse kane njohuri te mira mbi territorin dhe per aspekte te tjera. Per kete arsye AK duhet te kontrolloje perberjen aktuale te stafit qe OE/BOE ka ne dispozicion duke marre ne konsiderate se numri minimal per ekipin sipas Udhezuesit te planit te Mbareshtimit duhet te jete 3 dhe eshte mire qe te kete edhe disa persona te tjere qe te perfshihen ne kete pune per te siguruar nje efektivitet me te mire. Numri total i inxhinjereve te pyjeve apo teknikeve duhet te jete ne perputhje me karakteristikat e ekonomise pyjore (siperfaqja e saj, tipet e pyjeve, kushtet e terrenit etj.). Ekipi per hartimin e planit te mbareshtimit duhet te kete perberje :

- 1 (nje) Inxhinier Pyjesh i cili do te jete dhe Drejtues Teknik (Drejtues i grupit te punes) per te realizuar nje planifikim shume-funksional.
- 2 (Dy) Inxhiniera Pyjesh qe do te duhet te angazhohen ne punimet e terrenit.

- **1 (nje) Inxhinier Gjeodet / Gjeoinformatike ekspert GIS per pergatitjen e hartave dhe menaxhimin e te dhenave dixhitale.**
- **2 (Dy) teknike Pyjesh, me eksperiene, ne organizim dhe ne menaxhimin e procesit te pjesmarries duke siguruar pjesmarrjen ne staf te cilet te lehtesoje angazhimin e aktoreve, ne proceset e trajnimit dhe puneve te terenit.**

2.3.4. OE/BOE Pjesmares, duhet te deklaroje Drejtuesin teknik I cili eshte pergjegjës për drejtimin teknik, per mbajtjen, perputhshmërinë ligjore dhe përfaqësimin e planit të hartuar pranë institucioneve perkatese.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuara dhe nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar dhe bazuar në Kreun IV, të VKM nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e Rregullores të Procedurave te dhenies te licensave”,

2.3.4 Operatori Ekonomik pjesemares, per realizimin e ketij projekti ne teren duhet te kete mjetet dhe pajisjet si meposhte:

Makine 4x4	2cope	Pronësi/ose me qera
Klinometer	2 cope	Pronësi/ose me qera
Hipsometer	2 cope	Pronësi/ose me qera
PH -METER	2 cope	Pronësi/ose me qera
Tryele	2 cope	Pronësi/ose me qera
Peshore per peshimin e barit ne kullota	2 cope	Pronësi/ose me qera
Diameter mates	2 cope	Pronësi/ose me qera
GPS	2 copE	Pronësi/ose me qera

-Per makinat duhet te paraqiten: Ne rast se jane ne pronesi: dokumenti qe verteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), certifikata e pronesise, certifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit.

Kur makinat jane me qera duhet te paraqitet :kontrata e qerase e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi, e shoqeruar me lejen e qarkullimit, certifikaten e pronesise, certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit.

Për pajisjet e tjera , të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqese fatura tatimore e blerjes e deklarur ne organet tatimore, kontrate blerje, kontrate dhurimi ose cdo forme tjeter e fitimit te pronesise, ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë dhe fatura tatimore e blerjes e deklarur ne organet tatimore.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohej sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, bazuar në ”Manualin e planeve të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave”, të miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me Nr.864 prot., datë 30.01.2019, ne germen A.2 ”Kontrolli i pajisjeve ne ngarkim të stafit te pyjeve”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të jete i pajisur dhe të paraqese certifikatat e leshuara nga organizmat e vleresimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombetar i akreditimit DPA, ose organizma nderkombetare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, të jene të vlefshme, **e që kanë lidhje me objektin e kontrates, si me poshte:**

1) **ISO 9001** ose ekuivalente, të sistemit të menaxhimit të cilësisë (e vlefshme);

2) **ISO 27001** ose ekuivalente, për Sigurinë e Informacionit (e vlefshme);

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, I ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që si kompani kanë kualifikimet/certifikimet e duhura organizative dhe operacionale të nevojshme për të zbatuar kontratën.

Certifikimi ISO 9001 ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontrates në fjalë në mënyrë cilësore dhe të plotë, bazuar në organizimin e brendshëm për menaxhimin sa më të mirë të cilësisë implementuese. Ky certifikim kërket në përputhje me proporcionalitetin e vlerës së fondit limit të venë në dispozicion dhe bazuar në kompleksitetin dhe rëndësinë e funksionalitetit online të sistemeve dhe metodologjisë që ka në përdorim.

Certifikimi ISO 27001 ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontrates në fjalë duke siguruar që informacionet (siç janë ato që përmbajnë sistemet ekzistuese të AK dhe e kanë një rëndësi dhe konfidencialitet të lartë) të menaxhohen në mënyrë të sigurtë nga pikepamja informatike dhe të jene të kontrolluara si dhe aksesimi mbi to të jete i verifikueshëm e i kodifikuar). Kjo vjen pasi në këto kontrate do të ketë edhe përdorim të aplikacioneve që kërkojnë kompetencë të shtuar profesionale në këto drejtim. Ky certifikim kërket në përputhje me proporcionalitetin e vlerës së fondit limit të venë në dispozicion dhe bazuar në kompleksitetin dhe rëndësinë e funksionalitetit online të sistemeve aktuale që ka në përdorim.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet teknike janë hartuar nga komisioni i ngritur me urdhër të titullarit Nr. 241 Prot. Date 28.02.2025 duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për shërbimet objekt prokurimi, duke përllogaritur preventivin, termat e references.(bashkengjitur dokumentave të tenderit)

NJESIA E PROKURIMIT: